



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-2020-08

Vendosi: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatës Vidar Stensland, kryetar i panelit
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Antonio Balsamo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 prill 2020

Gjuha: Anglishte

Emri i dosjes: Kërkesë Referuese e [REDAKTUAR] drejtuar panelit të Gjykatës Kushtetuese në vijim të vendimit të Gjykatësit të Vetëm të Dhomave të Specializuara të Kosovës

Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i

Vendimit mbi Kërkesën Referuese të [REDAKTUAR] në vijim të vendimit të Gjykatësit të Vetëm

Gjykatësit të Vetëm

Gjykatës Nikola Giju

Parashtruesit

[REDAKTUAR]

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

e përbërë nga

Vidar Stensland, kryetar i panelit

Roland Dekers, gjykatës

Antonio Balsamo, gjykatës

pas kuvendimeve nga distanca nxjerr Vendimin e mëposhtëm

I. PROCEDURA

A. KËRKESA REFERUESE

1. Më [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] (“Parashtruesi”) i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“Dhoma”)¹ një Kërkesë Referuese që mban datën [REDAKTUAR] (“Kërkesa Referuese”),² bazuar në nenin 113(2) dhe (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Kushtetuta”). Parashtruesi përfaqësohej prej [REDAKTUAR].³

2. Në Kërkesën Referuese, Parashtruesi paraqiti ankesë ndaj vendimit të Gjykatësit të Vetëm të Dhomave të Specializuara të Kosovës [REDAKTUAR] (“Vendimi”)⁴ me të cilin Gjykatësi i Vetëm refuzoi të rishqyronte vendimin e vet të mëparshëm për rrëzimin e kërkesës së Parashtruesit për leje për apel.⁵ Si rezultat, [REDAKTUAR]

¹ Lidhur me caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), shih [REDAKTUAR]

² [REDAKTUAR] (“Kërkesa Referuese”).

³ [REDAKTUAR].

⁴ [REDAKTUAR] (“Vendimi”).

⁵ [REDAKTUAR].

urdhra⁶ të mëhershëm të lëshuar për Parashtruesin [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR] “Urdhrat”), mbetën në fuqi [REDAKTUAR] (shih paragrafët 13-14 më poshtë).

B. KËRKESA PËR MASA TË PËRKOHSHME

3. Më [REDAKTUAR], Parashtruesi paraqiti një kërkesë për masa të përkohshme⁷ (“Kërkesa”), në bazë të rregullës 21(1) të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“Rregullorja e Punës”). Parashtruesi i kërkoi Dhomës të pezullonte Urdhrat deri në marrjen e një vendimi prej Dhomës mbi Kërkesën Referuese.

C. PEZULLIMI I URDHRAVE

4. Në kohën kur mori Kërkesën, Dhoma nuk i kishte Urdhrat, e as dokumente të tjera përkatëse, për shkak të nivelit të klasifikimit të tyre në procedurën para Gjykatësit të Vetëm. Në të vërtetë, Kërkesa Referuese ishte i vetmi dokument që posedonte Dhoma. Si rrjedhojë, Dhoma nuk ishte në gjendje t’i bënte vlerësimin e duhur Kërkesës në përputhje me rregullën 21 të Rregullores së Punës. Gjithashtu, Dhoma nuk ishte e sigurt se çfarë ndikimi mund të kishte [REDAKTUAR] Urdhrave në marrjen e vendimit të duhur prej Dhomës mbi Kërkesën Referuese. Njëkohësisht, nga Kërkesa Referuese dukej se [REDAKTUAR]. Për më tepër, dukej se Kërkesa Referuese ngrinte një çështje të së drejtës për jetë bazuar në nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa”) (shih paragrafin 24 më poshtë).

5. Për këto arsye, më [REDAKTUAR], Dhoma mori vendimin që të “nxjerrë urdhra që i gjykon të nevojshëm për marrjen e vendimit të duhur mbi kërkesën referuese”, në përputhje me rregullën 24 të Rregullores së Punës. Në veçanti, ajo pezulloi [REDAKTUAR] Urdhrave deri në marrjen e vendimit prej Dhomës mbi Kërkesën e Parashtruesit për masa të përkohshme, ose deri në një urdhër të mëtejshëm.⁸ Më të

⁶ [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]

⁷ [REDAKTUAR]

⁸ [REDAKTUAR]

njëjtën ditë, Dhoma i kërkoi Gjykatësit të Vetëm që t'i mundësonte qasje në Urdhrat dhe në dokumente të tjera, në mënyrë që Dhoma të mund të shqyrtonte Kërkesën për masa të përkohshme dhe Kërkesën Referuese.⁹

D. MASA E PËRKOHSHME

6. Më [REDAKTUAR], Gjykatësi i Vetëm i mundësoi Dhomës qasje në Urdhrat dhe në dokumente të tjera përkatëse.¹⁰ Rrjedhimisht, Dhoma ishte në pozitë të shqyrtonte siç duhej Kërkesën e Parashtruesit për masa të përkohshme.

7. [REDAKTUAR].¹¹

8. Për këto arsye, më [REDAKTUAR], Dhoma vendosi të pezullonte ato pjesë të Urdhrave që [REDAKTUAR], deri në marrjen e vendimit prej Dhomës mbi Kërkesën Referuese, ose deri në një urdhër të mëtejshëm. Dhoma hodhi poshtë pjesën tjetër të Kërkesës së Parashtruesit për masa të përkohshme.

E. PARASHTRIMET ME SHKRIM

9. Më [REDAKTUAR], ZPS-ja dhe Parashtruesi dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim,¹² ku trajtonin pyetjet e parashtruara nga Dhoma në bazë të rregullës 15(2) të Rregullores së Punës.¹³

F. SHQYRTIMI I KËRKESËS REFERUESE

10. Dhoma tani do të shqyrtojë Kërkesën Referuese mbi bazën e Kërkesës Referuese, Kërkesës për masa të përkohshme, dokumenteve të dorëzuara nga Gjykatësi i Vetëm,¹⁴ ndër të cilat Urdhrat dhe Vendimi, si edhe parashtrimeve me shkrim të ZPS-së dhe Parashtruesit përmendur më lart. Dhoma do t'u referohet fakteve të çështjes

⁹ [REDAKTUAR]

¹⁰ [REDAKTUAR]

¹¹ [REDAKTUAR]

¹² [REDAKTUAR] ("Parashtrimet e ZPS-së"); [REDAKTUAR] ("Përgjigja e Parashtruesit").

¹³ [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]

¹⁴ [REDAKTUAR]

dhe parashtrimeve të ZPS-së dhe Parashtruesit për aq sa ato janë relevante për vlerësimin prej Dhomës të Kërkesës Referuese.

II. FAKTET

A. KËRKESAT E ZPS-SË PËR INFORMACION

11. [REDAKTUAR]¹⁵

12. [REDAKTUAR]^{16 17}

B. URDHRAT [REDAKTUAR]

13. [REDAKTUAR]

14. [REDAKTUAR]¹⁸

C. PARASHTRIMET PARA GJYKATËSIT TË VETËM

15. [REDAKTUAR]¹⁹

16. [REDAKTUAR]

D. VENDIMI I GJYKATËSIT TË VETËM

17. [REDAKTUAR]²⁰

18. [REDAKTUAR]

19. [REDAKTUAR]

¹⁵ [REDAKTUAR]

¹⁶ Shih po aty, para. 4, ku i referohet [REDAKTUAR]

¹⁷ [REDAKTUAR]

¹⁸ [REDAKTUAR]

¹⁹ [REDAKTUAR]

²⁰ [REDAKTUAR]

E. PËRDPJEKJET E PARASHTRUESIT PËR APELIMIN E VENDIMIT

20. [REDAKTUAR]²¹

21. [REDAKTUAR]^{22 23}

22. [REDAKTUAR]²⁴

23. Më [REDAKTUAR], Gjykatësi i Vetëm refuzoi të rishqyrtonte vendimin e vet të mëparshëm për rrëzimin e kërkesës së Parashtruesit për leje për apelimin e vendimit të tij [REDAKTUAR]²⁵ Gjykatësi i Vetëm theksoi se rishqyrtimi ishte një masë e jashtëzakonshme që mund të zbatohet vetëm në rast të një arsytimi qartësisht të gabuar, ose kur është i nevojshëm për të shmangur padrejtësinë. Në çështjen aktuale, nuk ishin plotësuar këto kushte. Rrjedhimisht, Urdhrat e kontestuar mbetën në fuqi.

III. SHKELJET E PRETENDUARA

24. Parashtruesi u ankua se [REDAKTUAR], Gjykatësi i Vetëm nuk vlerësoi domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e tyre, e as [REDAKTUAR]. Nxjerrja e informacionit të kërkuar rrezikonte sigurinë dhe privatësinë e [REDAKTUAR] dhe ishte në kundërshtim me ligjin. Procedura para Gjykatësit të Vetëm kishte shkelur kriteret e gjykimit të drejtë. Parashtruesi u mbështet në nenet 31 dhe 36(2) të Kushtetutës dhe nenet 2, 6 dhe 8 të Konventës.

IV. JURIDIKSIONI

25. Dhoma vëren se Parashtruesi paraqiti Kërkesën Referuese në bazë të nenit 113(2) dhe (7) të Kushtetutës.²⁶ Në Kërkesën Referuese, Parashtruesi u ankua për masat

²¹ [REDAKTUAR]

²² [REDAKTUAR]

²³ Po aty, para. 34, 40, 42.

²⁴ [REDAKTUAR]

²⁵ [REDAKTUAR]

²⁶ Kërkesa Referuese, para. 15-16, 19.

hetimore [REDAKTUAR] të konfirmuara nga Gjykatësi i Vetëm i Dhomave të Specializuara të Kosovës. Rrjedhimisht, Kërkesa Referuese është në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, sikurse kërkon neni 162(3) i Kushtetutës dhe nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Nga kjo rrjedh se Dhoma ka juridiksion të marrë vendim mbi Kërkesën Referuese.

V. PRANUESHMËRIA

A. PARASHTRIMET

1. Parashtruesi

26. Në lidhje me të drejtën e vet ligjore për paraqitjen e Kërkesës Referuese, Parashtruesi fillimisht parashtrroi se në bazë të rregullës 4(b) të Rregullores së Punës, kjo Dhomë kishte juridiksion për referime të paraqitura prej “personave të autorizuar për t’i paraqitur referime Gjykatës Kushtetuese të Kosovës sipas nenit 113 të Kushtetutës [...]”. Më tej, sipas nenit 113(2) të Kushtetutës, ‘qeveria’ ishte e autorizuar të ngrinte çështje para Gjykatës Kushtetuese. Parashtruesi [REDAKTUAR] përfshihej në kategorinë e ‘qeverisë’ sipas nenit 113(2) dhe rrjedhimisht ishte i autorizuar të paraqiste Kërkesën Referuese.²⁷

27. Së dyti, Parashtruesi kishte të drejtë ligjore të paraqiste Kërkesën Referuese për “shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë” në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës dhe rregullës 20(1) të Rregullores së Punës. Ishte gjithashtu relevante që në rastin nr. KI 120/11 para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës,²⁸ Ministria e Shëndetësisë mundi të parashtronte referim në bazë të nenit 21(4) të Kushtetutës, i cili përcakton se “[t]ë drejtat dhe liritë themelore [...] vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

²⁷ Kërkesa Referuese, para. 13, 15, 19; Përgjigjja e Parashtruesit, para. 13, 15, 19.

²⁸ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Parashtrues Ministria e Shëndetësisë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme A.nr.551, të 20 qershorit 2011*, KI 120/11, Aktvendim për papranueshmëri, 9 korrik 2012 (4 dhjetor 2012).

Rrjedhimisht, edhe Parashtruesi kishte të drejtë të paraqiste Kërkesën Referuese. Parashtruesi mund të pretendonte se ishte viktimë e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, si dhe viktimë e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të [REDAKTUAR] dhe ishin viktima të Urdhrave tejet gjithëpërfshirës.²⁹

28. Më tej, Parashtruesi argumentoi se procedura para Gjykatësit të Vetëm kishte shkelur kriteret e gjykimit të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës[REDAKTUAR]³⁰

29. Parashtruesi gjithashtu vuri në dukje [REDAKTUAR]. Gjykatësi i Vetëm e kishte zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 2 të Konventës. Ai gjithashtu nuk kishte marrë parasysh faktin që Urdhri [REDAKTUAR] i kërkonte Parashtruesit të shkelte detyrimin e vet sipas nenit 8 për garantimin e privatësisë së [REDAKTUAR]³¹

2. ZPS-ja

30. Së pari, lidhur me të drejtën ligjore të Parashtruesit për paraqitjen e Kërkesës Referuese në bazë të nenit 113(2) të Kushtetutës, ZPS-ja parashtrroi se fushëveprimi i kësaj dispozite kufizohej në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, dekreteve, rregulloreve të qeverisë dhe statuteve të komunave. Kjo dispozitë nuk jepte të drejtë ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore si ky që diskutohet këtu.³²

31. Së dyti, lidhur me nenin 113(7) të Kushtetutës, ZPS-ja parashtrroi se Parashtruesi nuk ishte 'individ' në kuptimin e këtij neni dhe nuk mund të paraqiste Kërkesën Referuese. Për aq sa neni 21(4) i Kushtetutës përcakton se "[t]ë drejtat dhe liritë themelore [...] vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme", kjo dispozitë duhet të interpretohet se u referohet personave juridikë joqeveritarë që kanë

²⁹ Kërkesa Referuese, para. 16-19; Përgjigjja e Parashtruesit, para. 16-19, 22-24.

³⁰ Kërkesa Referuese, para. 21-22, 24, 34; Përgjigjja e Parashtruesit, para. 11, 25.

³¹ Kërkesa Referuese, para. 26-33, 38, 40, 42, 46 *et seq.*; Përgjigjja e Parashtruesit, para. 9, 11-12, 20-22, 27 *et seq.*

³² Parashtrimet e ZPS-së, para. 19.

të drejtë ligjore të paraqesin referim në bazë të nenit 113(7). Nga ana tjetër, organet [REDAKTUAR] këtë mund ta bëjnë vetëm në rrethanat e përcaktuara në pjesën e mbetur të nenit 113.³³

32. ZPS-ja theksoi se një interpretim si ky ishte në përputhje me Konventën, sipas së cilës organizatat qeveritare nuk mund të paraqisnin ankesë për shkelje të të drejtave dhe lirive individuale.³⁴ Arsyeja për këtë kufizim ishte të parandalohet që autoritetet publike të ishin njëkohësisht pala paditëse dhe pala e paditur në procese para Gjykatës së Strasburgut. ZPS-ja argumentoi se ky arsyetim ishte gjithashtu relevant në kontekst të interpretimit të nenit 113(7) të Kushtetutës, i cili i përcaktonte qartë autoritetet publike si palë e paditur në procese që ndikojnë në të drejtat e individëve.³⁵

33. ZPS-ja më tej theksoi se në marrjen e vendimit nëse Parashtruesi është ligjërish i autorizuar të paraqesë Kërkesën Referuese, mundësia e pjesëmarrjes së Parashtruesit në procedurën para Gjykatës të Vetëm nuk ishte relevante. Për më tepër, në atë procedurë Parashtruesi kishte pretenduar të drejtën për privatësi të individëve të tjerë. Për këtë arsye, rrethanat në rastin e tanishëm ishin të ndryshme nga ato në rastet nr. KI 76/16³⁶ dhe KI 120/11,³⁷ ku Gjykata Kushtetuese e Kosovës kishte pranuar se qeveria mund të referonte çështje në bazë të nenit 113(7). Në veçanti, në këto raste qeveria kishte pretenduar shkelje të vetë të drejtave të saj në kontekst të një padie civile ku qeveria kishte qenë palë.³⁸ Për aq sa Parashtruesi pretendonte shkelje të të drejtave të njeriut të individëve të tjerë, ai nuk kishte të drejtë ligjore të angazhohej në ballafaqim juridik për të drejtat e tyre.³⁹

³³ Po aty, para. 20-23.

³⁴ I referohet nenit 34 të Konventës.

³⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 24.

³⁶ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 41/2016, të 14 marsit 2016*, KI 76/16, Aktvendim për papranueshmëri, 16 shtator 2016 (7 nëntor 2016), para. 44.

³⁷ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 120/11, cituar më lart, para. 40.

³⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 28-33.

³⁹ Po aty, para. 21.

B. VLERËSIMI I DHOMËS

1. Fushëveprimi i rishqyrtimit

34. Fillimisht, Dhoma vëren se në Kërkesën Referuese, Parashtruesi në thelb i paraqiti argumentet e veta për t'u shqyrtuar nga Dhoma në të njëjtën mënyrë si në kërkesën e vet të mëparshme për leje për apel drejtuar Gjykatësit të Vetëm (shih paragrafin 20 më lart). Në këtë kontekst, në disa pjesë të Kërkesës Referuese, Parashtruesi dukej se argumentonte para Dhomës që përfundimet e Gjykatësit të Vetëm ishin të gabuara si në aspektin faktik, po ashtu edhe ligjor.⁴⁰

35. Në lidhje me sa më lart, Dhoma rithekson se në bazë të nenit 49(1) dhe (3) të Ligjit, detyra e saj është të vlerësojë nëse parregullsitë për të cilat ankohet Parashtruesi kanë shkelur të drejtat dhe liritë individuale të tij të garantuara me Kushtetutë. Dhoma nuk ka për detyrë të trajtojë gabime faktike ose ligjore që pretendohet të jenë bërë gjatë procedurës penale, përveçse dhe vetëm nëse këto gabime mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë.⁴¹

36. Në përputhje me këtë, Dhoma nuk ka për detyrë të përcaktojë nëse përfundimet e Gjykatësit të Vetëm ishin të sakta në aspektin faktik ose ligjor. Përndryshe, Dhoma do të vepronte si një dhomë apeli, që do të nënkuptonte mosrespektimin e kufizimeve

⁴⁰ Shih, për shembull, Kërkesa Referuese, para. 39, 43. Vërehet po ashtu se Kërkesa Referuese është titulluar si 'Kërkesë [REDAKTUAR]për apelin e vendimit [...] të panelit të përbërë prej një gjykatësi të vetëm [...]'.
⁴¹ KSC-CC-2019-07, F00013, Vendim mbi kërkesën referuese të Driton Lajçit në lidhje me procedurën e marrjes në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, publik, 13 janar 2020, para. 18 ("Vendim mbi kërkesën referuese të Driton Lajçit"); KSC-CC-2019-05, F00012, Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018, publik, 20 shkurt 2019, para. 50 ("Vendim mbi referimin e Mahir Hasanit"). Shih ECtHR/GJEDNJ, *Bochan v. Ukraine* (nr. 2) [GC], nr. 22251/08, ECHR 2015, para. 61; *Perez v. France* [GC], nr. 47287/99, ECHR 2004-I, para. 82. Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017*, KI 37/18, Aktvendim për papranueshmëri, 30 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 38; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 44/2018, të 10 prillit 2018*, KI 72/18, Aktvendim për papranueshmëri, 22 nëntor 2018 (14 dhjetor 2018), para. 40; *Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit Nr. 2407/2006 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 30 shtatorit 2009*, KI 55/09, Aktgjykim, 13 dhjetor 2010 (6 prill 2011), para. 18, 21.

të juridiksionit të saj që i imponojnë nenet 113 dhe 162(3) të Kushtetutës.⁴² Në raste të jashtëzakonshme, Dhoma mund t'i vërë në dyshim këto përfundime nëse ato janë arbitraret flagrant dhe i qartë, në një mënyrë që shkakton në vetvete një shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.⁴³

37. Gjithsesi, para se të mund të shqyrtojë Kërkesën Referuese për aq sa në të pretendohen shkelje të të drejtave kushtetuese, Dhoma së pari duhet të përcaktojë nëse Kërkesa Referuese është e pranueshme.

2. Konstatime mbi pranueshmërinë

(a) E drejta ligjore për paraqitjen e Kërkesës Referuese

(i) A është Parashtruesi 'palë e autorizuar'

38. Dhoma rithekson se në bazë të nenit 113(1) të Kushtetutës, ajo "vendos vetëm për rastet e ngritura para [saj] [...] nga *palë të autorizuar*". (theximi i shtuar) Parashtruesi argumentoi se ishte 'palë e autorizuar' mbi dy baza.

39. Së pari, Parashtruesi u mbështet në nenin 113(2) të Kushtetutës, i cili, për aq sa është relevant në këtë çështje, përcakton si vijon:

[...] Qeveria [...] janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim [para Gjykatës Kushtetuese]:

- (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
- (2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

40. Lidhur me nenin 113(2), Parashtruesi parashtrroi se duhet të konsiderohet si 'qeveri' dhe rrjedhimisht si i autorizuar për të paraqitur Kërkesën Referuese. Dhoma

⁴² Shih ECtHR/GJEDNJ, *Kemmache v. France* (no. 3), 24 nëntor 1994, Seria A nr. 296-C, para. 44. Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit PML nr. 41/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 3 korrikut 2017*, KI 119/17, Aktvendim për papranueshmëri, 3 prill 2019 (3 maj 2019), para. 87; KI 37/18, cituar më lart, para. 38-39.

⁴³ Shih ECtHR/GJEDNJ, *Sisojeva and Others v. Latvia* (heqje e çështjes nga lista) [GC], nr. 60654/00, ECHR 2007-I, para. 89. Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 37/18, cituar më lart, para. 41; *Vlerësim i Kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl nr. 45/12 të datës 18 qershor 2012*, KI 85/12 dhe KI 86/12, Aktvendim për papranueshmëri, 21 janar 2013 (22 janar 2013), para. 28.

vëren se 'qeveria' përmendet si palë e autorizuar edhe në nenin 113(3) të Kushtetutës, i cili në pjesët përkatëse përcakton si vijon:

[...] Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim para Gjykatës Kushtetuese:

- (1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
- (2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;
- (3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;
- (4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues [...] dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
- (5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.

41. Dhoma nuk është e mendimit se Parashtruesi [REDAKTUAR] mund të konsiderohet si 'qeveri' në bazë të dispozitave të lartpërmendura. Në këtë kontekst, Dhoma vëren se në rastin nr. KO 124/19, Gjykata Kushtetuese konstatoi se qeveria në atë çështje e kishte parashtruar kërkesën referuese si palë e autorizuar sipas nenit 113(2) dhe (3) të Kushtetutës, ku kërkesa ishte dorëzuar në emër të qeverisë nga Kryeministri i Kosovës.⁴⁴ Lidhur me këtë, është me rëndësi të theksohet se, në të vërtetë, sipas nenit 94(1) të Kushtetutës, Kryeministri e përfaqëson qeverinë. Gjithashtu, edhe në rastin nr. KO 98/11, Kryeministri kishte dorëzuar kërkesë referuese në emër të qeverisë.⁴⁵ Megjithatë, në çështjen aktuale, Parashtruesi nuk specifikoi se mbi çfarë baze ligjore e kishte paraqitur Kërkesën Referuese si 'qeveri'.

42. Sidoqoftë, çështjet e ngritura në Kërkesën Referuese nuk përfshihen në çështjet të cilat 'qeveria' është e autorizuar t'ia referojë Gjykatës Kushtetuese sipas paragrafit (2), apo qoftë edhe paragrafit (3), të nenit 113.⁴⁶ Kërkesa Referuese nuk ka të bëjë me përputhshmërinë e ligjeve, dekreteve, rregulloreve apo statuteve me Kushtetutën, sikurse përcaktohet në nenin 113(2), e as me çështje konflikti ose përputhshmërie, apo

⁴⁴ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Kërkesë për interpretim të aktit të dorëheqjes së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe definimin e kompetencave dhe funksionimit të Qeverisë pas dhënies së dorëheqjes së Kryeministrit*, KO 124/19, Aktvendim për papranueshmëri, 4 shtator 2019 (16 shtator 2019), para. 1, 35.

⁴⁵ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KO 98/11, Aktgjykim, 20 shtator 2011, para. 1.

⁴⁶ Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 124/19, cituar më lart, para. 38, 50.

çështje që përcaktohen në nenin 113(3). Kërkesa Referuese ka të bëjë me masa hetimore të urdhëruara dhe më pas të konfirmuara nga Gjykatësi i Vetëm.

43. Në lidhje me këtë, është e paqartë për Dhomën nëse Parashtruesi pretendoi se në bazë të rregullës 4(b) të Rregullores së Punës kishte të drejtë ligjore të paraqiste Kërkesën Referuese pavarësisht nga çështjet e ngritura, përderisa ishte ‘palë e autorizuar’ sipas nenit 113 (shih paragrafin 26 më lart). Sido që të jetë, Dhoma duhet të theksojë, për hir të plotësisë, se rregulla 4(b) trajton referimet e paraqitura “në bazë të nenit 49(2) të Ligjit”, i cili nga ana e tij i referohet nenit 113 të Kushtetutës. Nga kjo rrjedh se Kërkesa Referuese duhet të plotësojë kushtet e nenit 113 të Kushtetutës.

44. Sikurse theksohet më lart, paragrafët (2) dhe (3) të nenit 113 autorizojnë ‘qeverinë’ të ngrejë para Gjykatës Kushtetuese vetëm disa çështje të caktuara (shih paragrafin 42 më lart). Parashtruesi nuk e ka paraqitur Kërkesën Referuese në lidhje me ndonjërin nga ato çështje. Nga kjo vijon se, sido që të jetë, Parashtruesi nuk ka të drejtë të paraqesë Kërkesën Referuese në bazë të nenit 113(2), mbi të cilin bazohet Parashtruesi, e as në bazë të nenit 113(3) të Kushtetutës.

45. Së dyti, Parashtruesi u mbështet në nenin 113(7) të Kushtetutës, i cili në pjesën përkatëse përcakton si vijon:

Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë [...]

46. Dhoma vëren se neni 113(7) autorizon ‘individët’ të paraqesin referime. Lidhur me këtë, është relevante se sipas nenit 21(4) të Kushtetutës, “[t]ë drejtat dhe liritë themelore [...]vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”. Më tej, [REDAKTUAR], Parashtruesi është person juridik.

47. Lidhur me argumentin e ZPS-së se neni 21(4) i Kushtetutës u referohet personave juridikë joqeveritarë, Dhoma vëren se nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës del një mendim i ndryshëm.

48. Konkretisht, Gjykata Kushtetuese ka konsideruar mundësinë që edhe persona juridikë publikë mund të kenë të drejtë ligjore për të paraqitur referim në bazë të nenit 113(7) lexuar bashkërisht me nenin 21(4) të Kushtetutës. Për shembull, në rastin nr. KI 76/16, qeveria kishte paraqitur referim në bazë të dispozitave kushtetuese të lartpërmendura lidhur me procedurën e kompensimit për pronë të shpronësuar. Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi që qeveria nuk ishte e autorizuar të paraqiste referimin në bazë të neneve 21(4) dhe 113(7). Në vend të kësaj, ajo e hodhi poshtë referimin si qartazi të pabazuar.⁴⁷

49. Ngjashëm, Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi që disa persona juridikë publikë të tjerë nuk ishin të autorizuar të paraqisnin referime në bazë të neneve 21(4) dhe 113(7), për shembull, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës, ose Ministria e Shëndetësisë, lidhur me procedurën e punësimit (rastet nr. KI 89/14 dhe KI 120/11),⁴⁸ apo Agjencia Kosovare e Privatizimit lidhur me procedurën e kompensimit të të ardhurave (rastet nr. KI 37/14 dhe KI 59/16)⁴⁹ ose dëmeve (rasti nr. KI 120/14).⁵⁰ Në disa raste të tjera, Gjykata Kushtetuese përdori qasje të ngjashme ndaj referimeve të paraqitura nga komunat në bazë të neneve 21(4) dhe 113(7) të Kushtetutës lidhur me procedurën e detyrimeve kontraktuale (rasti

⁴⁷ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 76/16, cituar më lart, para. 1, 4, 25-26, 30-45.

⁴⁸ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 287/2013, të 18 dhjetorit 2013*, KI 89/14, Aktvendim për papranueshmëri, 11 shkurt 2015 (20 mars 2015), para. 1, 4, 40-46; KI 120/11, cituar më lart, para. 1, 4, 24, 28, 30-41.

⁴⁹ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-12-0078, të 23 janarit 2014*, KI 37/14, Aktvendim për papranueshmëri, 25 mars 2014 (14 prill 2014), para. 1, 4, 22-23, 37; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0237, të 18 shkurtit 2016*, KI 59/16, Aktvendim për papranueshmëri, 25 mars 2014 (1 gusht 2016), para. 1, 6, 22, 38.

⁵⁰ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 79/2009, të 27 tetorit 2009, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 45/2012, të 20 majit 2013*, KI 120/14, Aktvendim për papranueshmëri, 12 shkurt 2015 (2 mars 2015), para. 1, 4, 19, 23. Shih gjithashtu *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-089, të 4 shkurtit 2010*, KI 25/10, Aktgjykim, 30 mars 2011 (31 mars 2011).

nr. KI 31/18),⁵¹ çështje punësimi (rasti nr. KI 07/10)⁵² ose kompensimin për pronën e shpronësuar (rastet e bashkuara nr. KI 48/14 dhe KI 49/14).⁵³

50. Duke marrë parasysh sa më lart, Dhoma e ka të vështirë të pranojë argumentin e ZPS-së se, në parim, personat juridikë publikë nuk mund të mbështeten në nenin 113(7) lexuar bashkërisht me nenin 21(4) të Kushtetutës. Njëkohësisht, Dhoma gjykon se nuk ka nevojë të marrë vendim për këtë aspekt në çështjen aktuale duke qenë se, gjithsesi, Kërkesa Referuese është e papranueshme për arsyet e mëposhtme.

(ii) A i gëzon Parashtruesi të drejtat sipas Kushtetutës

51. Dhoma vëren se në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkelje “të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë [...]”. Më tej, neni 21(4) përcakton se “[t]ë drejtat dhe liritë themelore [...]vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”. (theksimi i shtuar). Në përputhje me këtë, Parashtruesi është i autorizuar të paraqesë Kërkesën Referuese vetëm nëse faktikisht gëzon të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur. Nëse Parashtruesi nuk mund t’i gëzojë ato, qoftë në përgjithësi ose në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje, Dhoma duhet ta hedhë poshtë Kërkesën Referuese.

52. Në lidhje me këtë, Dhoma thekson se historikisht, të drejtat e njeriut u zhvilluan për të mbrojtur qenien njerëzore nga ushtrimi arbitrar i pushtetit shtetëror. Rrjedhimisht, shteti si person juridik publik *par excellence*, ka për detyrë të garantojë

⁵¹ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit E. Rev. nr. 20/2017, të 20 nëntorit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*, KI 31/18, Aktgjykim, 12 prill 2019 (23 prill 2019), para. 1, 5, 110-113.

⁵² Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësimi i kushtetutshmërisë të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, Nr. 112/08, të datës 5 qershor 2009*, KI 07/10, Aktvendim për papranueshmëri, 13 dhjetor 2010 (16 dhjetor 2010), para. 1, 28-30.

⁵³ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1369/14, të 27 qershorit 2014*, KI 48/14 dhe KI 49/14, Aktvendim për papranueshmëri, 15 mars 2016 (26 prill 2016), para. 1, 6, 49, 59, 63-65.

të drejtat dhe liritë themelore. Parashtruesi në këtë çështje është entitet publik që ushtron pushtet qeveritar. Për këtë arsye, ai gjithashtu ka për detyrë të garantojë të drejtat e njeriut. [REDAKTUAR].

53. Duke marrë parasysh sa më lart, arsyet për t'u dhënë të drejta dhe liri themelore personave juridikë sipas të drejtës publike janë më pak të forta se sa ato për personat juridikë sipas të drejtës private, që mund të luajë një rol të rëndësishëm në ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore nga qeniet njerëzore. Kjo vlen edhe më shumë kur një person juridik publik vepron si autoritet në pushtet, ose me fjalë të tjera, në kuadër të detyrave të veta si autoritet, në interesin publik dhe në ndjekjen e qëllimeve publike. Të thuhet se një entitet publik gëzon të drejta dhe liri themelore kur vepron nga pozita e pushtetit do të ishte në kundërshtim me vetë qëllimin e tij, që është të mbrojë individin nga ushtrimi arbitrar i atij pushteti.

54. Në këtë kontekst, Dhoma rikujton se [REDAKTUAR]. Roli, detyrat dhe kompetencat e Parashtruesit zbulojnë karakterin e tij kryesisht publik.

a. E drejta për privatësi dhe e drejta për gjykim të drejtë sipas Kushtetutës

55. Dhoma vëren se, duke marrë parasysh karakterin kryesisht publik të Parashtruesit, ai nuk është thjesht një grup individësh që lidhen dhe funksionojnë lirshëm për interesat e tyre personale. Përkundrazi, Parashtruesi është mjet për ushtrimin e pushtetit publik, për të siguruar mbrojtje nga i cili shërben e drejta për privatësi sipas nenit 36 të Kushtetutës.⁵⁴ Kjo ide është mishëruar gjithashtu në paragrafin (2) të nenit 36 të Kushtetutës, mbi të cilin mbështetet Parashtruesi, i cili përcakton garancitë gjatë kontrolleve të "cilësdo banese ose cilitdo objekti *privat*".

⁵⁴ Gjithashtu, lidhur me nenin 8 të Konventës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ") ka theksuar se "[o]bjekti themelor i nenit 8 është të mbrojë individin nga ndërhyrja arbitrare e autoriteteve publike". (theksimi i shtuar) Shih *P. and S. v. Poland*, nr. 57375/08, 30 tetor 2012, para. 94. Shih gjithashtu *Nunez v. Norway*, nr. 55597/09, 28 qershor 2011, para. 68.

(theksimi i shtuar) Edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka theksuar zbatueshmërinë e kësaj dispozite lidhur me kontrolle të banesave ose objekteve *private*.⁵⁵

56. Vetë Parashtruesi para kësaj Dhome dhe para Gjykatës të Vetëm parashtroi se kishte për detyrë të respektonte, ndër të tjera, të drejtën për privatësi të individëve (shih paragrafët 20 dhe 29 më lart). Parashtruesi gjithashtu kontestoi Urdhrin [REDAKTUAR] duke u bazuar në mandatin e vet publik [REDAKTUAR] (shih paragrafin 29 më lart). Nga kjo rrjedh se Parashtruesi pretendon të drejtën për privatësi në cilësinë e një autoriteti në pushtet. Për këtë arsye, Dhoma nuk është në gjendje të pranojë që [REDAKTUAR] Parashtruesit gëzon të drejtën e privatësisë sipas nenit 36 të Kushtetutës.⁵⁶

57. Në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës, Dhoma vë në dukje argumentet e Parashtruesit se [REDAKTUAR].

58. Nga kjo rrjedh se ajo që diskutohet këtu është mospajtimi i një autoriteti ndaj asaj nëse një autoritet tjetër ka ndërhyrë në mënyrë të lejueshme në sferën e kompetencave të tij. Duke marrë parasysh natyrën specifike të çështjes, Dhoma nuk është bindur nga argumenti i Parashtruesit (shih paragrafin 27 më lart) se kjo çështje është e ngjashme me rastin nr. KI 120/11 para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në të cilin Ministria e Shëndetësisë, si parashtruesi në atë rast, pretendoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë lidhur me procedurën e punësimit, në të cilën kishte qenë vetë palë.⁵⁷ Siç u theksua më lart, Parashtruesi në këtë çështje synon mbrojtjen e kompetencave të veta.⁵⁸

⁵⁵ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. Nr. 83/2013, të 19 qershorit 2013*, KI 129/13, Aktvendim për papranueshmëri, 10 shtator 2013 (9 tetor 2013), para. 55-56.

⁵⁶ Për krahasim, shih Slloveni, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i ankesave kushtetuese të Bankës së Sllovenisë dhe Bankës Qendrore Evropiane*, U-I-157/16, Up-729/16, Up-55/17, Urdhër, 19 prill 2018, para. 25.

⁵⁷ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 120/11, cituar më lart, para. 1, 3-4, 9-14.

⁵⁸ Për krahasim, shih Slloveni, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i ankesave kushtetuese të Bankës së Sllovenisë dhe Bankës Qendrore Evropiane*, U-I-157/16, Up-729/16, Up-55/17, Urdhër, 19 prill 2018, para. 27-29.

59. Në të njëjtën kohë, Dhoma mban parasysht që në rastin nr. KI 25/10, Gjykata Kushtetuese pranoi se e drejta për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës ishte e zbatueshme për një entitet publik, përkatësisht për Agjencinë Kosovare të Privatizimit ("AKP"). Megjithatë, ai rast buronte nga procedura në të cilën AKP-ja duhej të kishte qenë palë.⁵⁹ Në këtë çështje është ndryshe. Sipas Ligjit dhe Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, Parashtruesi nuk kishte statusin e palës në procedurën në të cilën Gjykatësi i Vetëm mori vendim mbi kërkesat e ZPS-së për Urdhrat. Për më tepër, Dhoma nuk mund të anashkalojë natyrën e procedurës para Gjykatësit të Vetëm. Konkretisht, procedura kishte të bënte me masa hetimore. Nuk bëhej fjalë për akuza penale kundër Parashtruesit.⁶⁰ Gjithashtu, procedura nuk kishte të bënte as me marrëdhënie që do t'u përngjanin në ndonjë mënyrë atyre të natyrës së të drejtës civile. Për më tepër dhe në dallim nga rasti nr. KI 25/10, Gjykatësi i Vetëm i dha Parashtruesit mundësi për të bërë parashtrime (shih paragrafin 15 më lart).

60. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma nuk mund të pranojë se në rrethanat e kësaj çështjeje Parashtruesi ka të drejtë të pretendojë shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë në bazë të nenit 31 të Kushtetutës.

b. E drejta për privatësi dhe e drejta për gjykim të drejtë në bazë të Konventës

61. Parashtruesi pretendoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të së drejtës për privatësi gjithashtu edhe mbi bazë të neneve 6 dhe 8 të Konventës (shih paragrafët 24, 28-29 më lart). Në lidhje me këtë, Dhoma rithekson se në bazë të nenit 22(2) të Kushtetutës, Konventa zbatohet në nivel kushtetues.⁶¹ Megjithatë, sipas jurisprudencës së pranuar të GJEDNJ-së, 'organizatat qeveritare' nuk kanë të drejtë

⁵⁹ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 25/10, cituar më lart, para. 1, 5, 17, 39, 45, 48, 51-52.

⁶⁰ Për dallim, krahaso me *Vendim mbi referimin e Mahir Hasanit*, para. 30-32.

⁶¹ Shih *Vendim mbi kërkesën referuese të Driton Lajçit*, para. 14. Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit*, KO 01/09, Aktgjykim, 27 janar 2010 (18 mars 2010), para. 40.

ligjore të paraqesin kërkesa në bazë të nenit 34 të Konventës.⁶² Parashtruesi është entitet publik që ushtron kompetencë qeveritare. Për këtë arsye, ai është një 'organizatë qeveritare' dhe si e tillë nuk ka të drejtë të pretendojë të drejtat në bazë të Konventës të përfshira në nenin 22(2) të Kushtetutës.

(iii) Pretendimet për shkelje të të drejtave të individëve

62. Së fundi, Dhoma vëren se Parashtruesi ka parashtruar që ishte viktimë e shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të [REDAKTUAR] sipas neneve 31 dhe 36 të Kushtetutës dhe neneve 2, 6 dhe 8 të Konventës (shih paragrafët 27-29 më lart). Në lidhje me këtë, Dhoma thekson se Parashtruesi nuk mund të pretendojë se është viktimë e këtyre shkeljeve të pretenduara thjesht me arsyetimin se individët përkatës [REDAKTUAR] (shih paragrafin 27 në fund më lart). Për më tepër, Parashtruesi nuk pretendoi se ishte caktuar që të përfaqësonte këta individë sipas rregullës 20(2) të Rregullores së Punës.⁶³

3. Përfundim i përgjithshëm

63. Duke marrë parasysh sa më lart, Dhoma konstaton se në rrethanat e kësaj çështjeje, Parashtruesi nuk është ligjërisht i autorizuar të paraqesë Kërkesën Referuese në bazë të nenit 113(2), (3) ose (7) të Kushtetutës, pavarësisht nga rëndësia e çështjeve që mund të ngrejë. Rrjedhimisht, Kërkesa Referuese nuk përfshihet në fushëveprimin e juridiksionit të Dhomës përcaktuar në nenin 113 të Kushtetutës. Dhoma nuk mund

⁶² ECtHR/GJEDNJ, *Assanidze v. Georgia* [GC], nr. 71503/01, ECHR 2004-II, para. 148; *Municipal Section of Antilly v. France* (dec.), nr. 45129/98, ECHR 1999-VIII. Shih gjithashtu *Radio France and Others v. France* (dec.), nr. 53984/00, ECHR 2003-X, para. 26.

⁶³ Shih, për shembull, European Commission on Human Rights, *Ayuntamiento de M. v. Spain*, nr. 15090/89, Commission decision of 7 January 1991, Decisions and Reports (DR) 68, f. 209. Krahaso me Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme*, Rev. nr. 182/2012, të 20 qershorit 2013, KI 30/18, Vendim për refuzimin e kërkesës, 11 qershor 2018, para. 2; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit*, PA1. nr. 313/16, të 10 majit 2016, KI 16/18, Vendim për refuzimin e kërkesës, 22 nëntor 2018 (31 dhjetor 2018), para. 1.

t'i shqyrtojë çështjet e ngritura, përveçse kur ato i janë referuar në mënyrë të ligjshme nga palë të autorizuara.⁶⁴

64. Për këto arsye, Dhoma duhet ta hedhë poshtë Kërkesën Referuese në bazë të nenit 49(2), (3) të Ligjit dhe rregullave 4(b), (c) dhe 14(a) të Rregullores së Punës, duke qenë se Parashtruesi nuk ka të drejtë ligjore për paraqitjen e saj.

65. Dhoma shton se përfundimet e lartpërmendura nuk cenojnë të drejtat procedurale që mund t'i takojnë Parashtruesit në bazë të Ligjit ose Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës. Ky vendim do të thotë vetëm se, në rrethanat e kësaj çështjeje Parashtruesi nuk ka të drejtë ligjore të paraqesë këtë Kërkesë Referuese para Dhomës.

VI. KLASIFIKIMI

66. Në lidhje me nivelin e klasifikimit të këtij vendimi, Dhoma rithekson se karakteri publik i dokumentacionit të saj lidhet drejtpërsëdrejti me parimin themelor të administrimit publik të drejtësisë, mishëruar në nenin 31(2) dhe (3) të Kushtetutës. Ky parim themelor i mbron personat përkatës kundrejt administrimit të fshehtë të drejtësisë, pa kontroll prej publikut. Karakteri publik i dokumentacionit është gjithashtu edhe një nga mënyrat për ruajtjen e besimit tek Dhoma. Dokumentacioni publik është thelbësor për ruajtjen e transparencës së procedurave me shkrim të Dhomës.⁶⁵

67. Në të njëjtën kohë, Dhoma e gjykon të përligjur nevojën për të devijuar nga karakteri publik i dokumentacionit të saj në çështjen aktuale. Në veçanti, është e domosdoshme që ky vendim të klasifikohet si rreptësisht konfidencial për të mbrojtur [REDAKTUAR].⁶⁶ Dhoma do ta rishikojë këtë klasifikim në momentin kur ai nuk do

⁶⁴ Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 124/19, cituar më lart, para. 55

⁶⁵ *Vendim mbi kërkesën referuese të Driton Lajçit*, para. 32.

⁶⁶ Shih po aty, para. 33.

të jetë më i domosdoshëm për interesat e hetimit. Sidoqoftë, deri në atë kohë, Dhoma duhet të sigurojë që ky vendim të jetë i disponueshëm për kontroll prej publikut për aq sa interesat e hetimit nuk diktojnë të kundërtën. Rrjedhimisht, Dhoma do të konsiderojë mundësinë që ky vendim t'i vihet në dispozicion publikut në version të redaktuar.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

1. *shpall* Kërkesën Referuese të paraqitur nga [REDAKTUAR] më [REDAKTUAR] të papranueshme;

2. *konfirmon* se masa e përkohshme e urdhëruar më [REDAKTUAR] pushon së qeni në fuqi menjëherë, në përputhje me rregullën 21(6) të Rregullores së Punës.

/nënshkrim/

Vidar Stensland

Kryetar i panelit

Përpiluar në anglishte, e hënë, 20 prill 2020

Në Hagë, Holandë